



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 12 Prot

Tiranë, më 08, 02, 2013

**VENDIM Nr. 238, dt. 08.02.2013**

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 08.02.2013 pasi shqyrtoi "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" paraqitur nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve HEC Dunicë 1 dhe HEC Dunicë 2, në pellgun e Dunicës (Pogradec) - Subjekti "HEC Dunicë" sh.p.k., Tiranë,

**VENDOSI:**

- I. Të miratojë "Raportin e vëzhgimit intensiv arkeologjik" përgatitur nga **Agjencia e Shërbimit Arkeologjik** për Projektin: "Ndërtimi i hidrocentraleve "HEC Dunicë 1 dhe HEC Dunicë 2, në Rrethin e Pogradecit", paraqitur nga Subjekti "HEC Dunicë" sh.p.k., Tiranë.
- II. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të zbatimit, nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Korçë bazuar në kontratën dypalëshe midis "HEC Dunicë" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- III. Nëse pas fillimit të punimeve, zbulohen rastësisht gjurmë ose objekte me vlera arkeologjiko-etnologjike, punimet ndërpriten menjëherë dhe investitori ("HEC Dunicë" sh.p.k.) duhet të njoftojë, brenda tri ditëve Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
ALDO BUMÇI**

**MINISTËR**

**SEKRETAR I KKA**

**ROLAND OLLI**

